



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.12/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit J.U., nga Ferizaji, ndaj gjyqtarit R.T., , gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, Departamentin e Përgjithshëm- Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e Gjyqtarit të lartcekur sipas lëndës P.nr.22/18, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.03.07.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit J.U., nga Ferizaji, e paraqitur ndaj gjyqtarit R.T., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës J.U., nga Ferizaji ka parashtruar Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ndaj Gjyqtarit R.T., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, Departamentin e Përgjithshëm- Divizioni Civil, lidhur me lëndën penale P.nr.22/18 dhe lëndën civile C.nr.288/19. Ankuesi në lëndën penale P.nr.22/18 është dënuar për shkak të veprës penale vetëgjyqësia, ku i është shqiptuar dënim me kusht dhe konsideron se i njëjti nuk është i bazuar në prova, por me një provë fiktive të deklaratës së rremë nga dëshmitari. Ankuesi pretendon se Gjyqtari ka shkelur të drejtën e tij kushtetuese për ankim respektivisht nenin 32 të Kushtetutës së Kosovës (e drejta për mjete juridike) pasi që nuk i është dorëzuar Aktgjykimi i lëndës P.nr.22/18 dhe me këtë iu është pamundësuar e drejta në ankesë. Lënda është dërguar në procedurën e përmbarimit. Pas kësaj ankuesi nëpërmjet avokates së autorizuar D.K., nga Suhareka ka parashtruar Kërkesë për rishikim të procedurës penale të përfunduar dhe gjykata me aktvendim PK.nr.27/2023 të datës 08.05.2023 ka refuzuar këtë kërkesë si të pabazuar, ku konsideron se në këtë vendim të kolegjit ka ndikuar gjyqtari R.T., tërthorazi dhe në afatin ligjor ankuesi ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të kolegjit në Gjykatën e Apelit, e cila është në rishqyrtim dhe nuk është vendosur ende.

Gjithashtu ankuesi ka cekur se gjyqtari ka gjykuar edhe lëndën C.nr.288/19 ku ai ka pasur cilësinë e të paditurit dhe së bashku me lëndët tjera është vendosur në disfavor të tij për të gjitha. Ankuesi më tej ka cekur sa ka parashtruar kërkesë për shlyerje nga evidenca e të dënuarve dhe gjithashtu për sigurim të gjitha shkresave të cilat kanë të bëjnë me lëndët e lartcekura. Sipas tij i janë dorëzuar pjesërisht shkresa të kërkuara dhe konsideron se edhe me këtë veprim i është shkelur e drejta në qasje të dokumenteve publike dhe ky veprim është i padrejtë dhe gjykata ka shkelur rregulloren Nr.02/2023. Në bazë të gjitha të lartcekurave ka parashtruar ankesë dhe kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit R.T., dhe ka kërkuar që Gjykata Themelore në Prizren Gjyqtari R.T., ka dhënë deklaratë në lidhje me lëndën civile C.nr.288/19 dhe lëndën penale P.nr.22/18. Në deklaratën e tij të dhënë në lidhje me lëndën civile C.nr. 288/19 ka cekur se ankuesi J.U., ka qenë në cilësi të palës së paditur ku Objekt kontesti ka qenë kthimi i borxhit. Në këtë çështje gjyqtari ka vendosur me Aktvendim me të cilin është konstatuar se padia e paditësit S.R.,

është e tërhequr pasi që paraprakisht i autorizuari i paditësit av. N.H., ka hequr dorë nga padia. Aktvendimi është bërë i plotfuqishëm me dt. 06.04.2023 dhe me këtë rast i padituri, ankuesi nuk ka pasur kurrfarë pasoja me këtë aktvendim, pra nuk është obliguar të paguaj borxhin. Sa i përket lëndës penale P.nr.22/18 gjyqtari në atë kohë ka qenë i caktuar në divizionin penal dhe ka nxjerr Aktgjykim me dt. 19.04.2019 me të cilin të akuzuarin J.U., e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me dënim me burgim me kusht. Aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm me dt. 05.06.2019. Në këtë çështje penale ankuesi ka parashtruar Kërkesë për rishikim të procedurës penale e Cila është evidentuar me numër PK.nr.27/2023 ku me dt. 08.05.2023 e njëjta është refuzuar si e pabazuar. Ndaj këtij aktvendimi ankuesi ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë ku është ende pa u vendosur. Gjyqtari ka deklaruar se në asnjë rrethanë dhe asnjë rast nuk ka trajtuar në mënyrë të pabarabartë palën ankuese, nuk ka pasur vonesë në trajtimin e lëndëve dhe se në vendimmarrje ka qenë i paanshëm, i pandikuar dhe ka vendosur sipas ligjit dhe në bazë të provave.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes R.T., ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës P.nr.22/18, PK.nr.27/2023 dhe C.nr.288/19. Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Ankuesi ka vërejtje në punën e Gjyqtarit R.T., lidhur me lëndën penale P.nr.22/18 dhe lëndën civile C.nr.288/19. Në lëndën penale P.nr.22/18 gjyqtari R.T., ka qenë i caktuar si gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm — Divizioni Penal dhe ka gjykuar sipas aktakuzës së Prokurorisë ndaj J.U., për veprën penale vetëgjyqësia nga neni 418 par.2 i KPK-së, ku i njëjti është shpallur fajtor dhe është dënuar me dënim me kusht në kohëzgjatje prej tre muajve, i cili nuk do të ekzekutohet në periudhën prej një viti nëse i njëjti kryen vepër të njëjtë apo të ngjashme penale. Është obliguar që të paguaj shpenzimet e gjykatës dhe i dëmtuari S.R., për realizimin e kërkesës pasurore është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Aktgjykimi është evidentuar si P.nr.22/18 e datës 19.04.2019. Ankuesi pretendon se nuk e ka pranuar këtë aktgjykim, por në shkresat e lëndës qëndron fletë dërgesa për dorëzim e datës 03.05.2019 në emër të J.U., të cilin e ka pranuar babai i tij Z.U., i cili edhe është evidentuar si babai. Gjithashtu ekziston edhe një fletë kthesë për pranimin e aktgjykimit e datës 13.05.2019 të cilën e ka pranuar vëllai M.U., me datë 17.05.2019, e që në bazë të kësaj konsiderohet se është kryer në mënyrë të rregullt dorëzimi i aktgjykimit. Pretendimet se nuk i është dorëzuar aktgjykimi nuk qëndrojnë dhe me këtë gjyqtari ka përfunduar në mënyrë të rregullt procedurën e gjykimit dhe dorëzimit të aktgjykimit dhe sipas rregullit kur lënda bëhet e plotfuqishme duhet të vazhdojë me procedurën e ekzekutimit. Sa i përket aktvendimit PK.nr.27/23 me të cilin anëtarët e kolegjit S.G., L.B., dhe Q.S., me datë 08.05.2023 kanë refuzuar kërkesën për rishikim të procedurës penale të përfunduar me aktgjykimin e formës së prerë ndaj aktgjykimit P.nr.22/18 të datës 19.04.2019, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 05.06.2019. Kjo kërkesë është refuzuar për arsye se pretendimet e të dënuarit mbështetur në deklaratën e rremë të dëshmitarit nuk qëndron, pasi që këto pretendime duhet të mbështeten në prova konkrete, që kanë të bëjnë me aktgjykimin e rremë. Gjithsesi kundër këtij aktvendimi ankuesi ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila pritet të vendoset në ndërkohë.

Në lëndën Civile C.nr.288/19 paditësi S.R., të cilin me autorizim e ka përfaqësuar av.N.H., nga Suhareka e ka paditur J.U., për pagesën e borxhit në shumë prej 700 € në bazë të aktgjykimit

të Gjykatës Themelore në Prizren — Dega në Suharekë P.nr. 22/18. Në këtë lëndë e ka gjykuar gjyqtari R.T., pasi që në ndërkohë është caktuar në Divizionin Civil. Me datë 03.04.2023 avokate N.H., ka parashtruar parashtrësën për tërheqjen e padisë për kthimin e borxhit pasi që paditësi nuk është interesuar që të vazhdoj me këtë çështje. Gjykata ka marrë aktvendim C.nr.288/19 me datë 06.04.2023 me të cilën padia konsiderohet se është tërhequr dhe lënda është bërë e plotfuqishme me datë 06.04.2023 dhe është arkivuar, ndaj të cilit aktvendim në bazë të nenit 261 par.4 të LPK-së nuk lejohet ankesa. Nga të lartcekurat konsiderohet se ankuesi J.U., në këtë rast e ka pasur cilësinë e të paditurit dhe se padia është tërhequr, shpenzimet e procedurës bien në barrë të paditësit dhe jo të të paditurit, ashtu që nuk ka kurrfarë pasoja për ankuesin. Gjithashtu fakti se është vendosur në disfavor të tij nuk qëndron. Vlen të theksohet se është tentuar dorëzimi i këtij aktvendimi por familjarët kanë refuzuar të pranojnë të njëjtin. Gjithsesi është e pabazë ankesa e ankuesit se gjyqtari në çdo rast ka vendosur në disfavor të tij.

Autoriteti Kompetent, vlerëson se pretendimet e ankueses nuk qëndrojnë dhe në rastin konkret nuk ka shkelje disiplinore gjatë zhvillimit të procedurës dhe gjatë seancave të mbajtura gjyqtari ka vepruar sipas autorizimeve duke zbatuar Ligjin e Procedurës Kontestimore, Rodin Penal dhe të Procedurës Penale dhe se janë respektuar të drejtat kushtetuese të ankuesit dhe të gjitha palëve në procedurë. Kjo është vërtetuar në bazë të shikimit të shkresave të lëndës, ku në rastin penal P.nr.22/18 lënda sipas ankesës është në Gjykatën e Apelit dhe se nëse ka shkelje procedurale Gjykata e shkallës së dytë do ta shqyrtoj dhe se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet juridike, ndërsa sa i përket lëndës C.nr.288/19 e njëjta është tërhequr si padi dhe se nuk ka shkaktuar kurrfarë pasojajuridike te ankuesi. Autoriteti kompetent konsideron se meqenëse ankuesi ka qenë i paditur, tërheqja e padisë nuk mund të jetë vendim i disfavorshëm për të.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligi nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.12/23, me dt. 03.07.2023



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk e lejuar e drejta e ankesës.